



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Muhamet Muciqi BI” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Muhamet Muciqi BI” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Muhamet Muciqi BI” (tutje “parashtruesi”) me datë 07.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Andaj duke marr për bazë dispozitat ligjore të nenin 4 të LPP-se ne si OE me pale me interese sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-se, edhe për kundër faktit se ne kemi kemi arritur të plotësojm të gjitha kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosje tenderit dhe njoftimin për kontratë, mirepo AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke na eliminuar padrejtësisht, duke ne diskriminuar në detyrohemi të parashtrojm kërkesë për rishqyrtim pran AK duke pasqyruar dhe një herë faktet dhe argumentet lidhur me Kerkesen 6 Stafin teknik dhe profesional – teknikun e makineri z. Agron Bytyqi - CV nuk është nënshkruar të cilat i kemi dorëzuar në platformën elektronike e-prokurim për këtë AK me rastin e aplikimit NE SI GOE arumentojmë dhe KONSTATOJME se të gjitha dokumentacionin e kërkuar për këtë AP janë në pajtim të plotë me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë – duke plotësuar në tërësi kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor të dhenies së kontratës – çmimi me i ulët i përgjegjshëm. Pasi që qëllimi i vetëm i AK – ZPP dhe Komisionit të vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve të bëjnë të pamundurën dhe të gjejë arsye të eliminimit GOE me çmimin me të ulët të përgjegjshëm, që kemi tender në vlerë: 69.59 € dhe të reagojmë duke eliminuar GOE me çmimin me të lartë në këtë AP në vlerë: 233.00 € - (Ky veprim i AK – ZPP Komisioni të vlerësimit është skandaloz tendencioz dhe në shkelje të kodit të etikës dhe parimeve të prokurimit konkretisht “VLERES PER PARA” sepse të rekomandohet një GOE me çmim afërsisht 195% me të lartë se sa Oferta jone pse CV e teknik nuk ka qenë e nënshkruar, kur dihet ka qenë kontrata e punës dhe gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe për një nënshkrim me na eliminuar dhe me demtuar BUXHETIN e Republikës së Kosovës në këtë masë është shqetësuese dhe skandalozë , kur dihet se shumë lehtë AK – Komisioni i vlerësimit ka mund të veprojnë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-se, apo edhe ose sipas nenit 52.7 të LPP-se, pasi që CV-ja e ka përmbushur kërkesat sipas nenit 69 të LPP-se, siç potencion neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023 sine vijim:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Parashtruesi ka prezantuar po ashtu edhe pretendimet ndaj tenderuesit të rekomanduar por edhe ofertuesve të tjerë.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për piken e kërkesës nr. 6. Kërkesa: *Një (1) teknik të makinerisë, i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 6. •Diplomën (kopje); •Certifikatat; •Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; •Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët;* Ju si GOE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertën tuaj keni prezantuar teknik të Makinerisë z. Agon Bytyqi dhe keni dorëzuar dokumentacionin: Diplomën, Certifikatat, Kontratë për kryerje të shërbimeve si dhe Biografinë CV-në - CV e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, andaj sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK / CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Neni 69. Ju si GOE-ik keni prezantuar – dorëzuar CV-në e pa nënshkruar nga kandidati z. Agon Bytyqi.

Andaj dhe për arsye të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi parimisht nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme por vetëm thekson që është dashur AK të kërkoj sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk ka aspak hapësirë për të kërkuar sqarime shtesë AK në kuptim të nenit 72 të LPP për arsye se sipas pikës 10 të UPP përcaktohet që në rastet kur CV nuk i përmbush kërkesat e DT – tenderi refuzohet pa kërkuar sqarime shtesë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesit e tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.07.2025



Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.